



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 13.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.03.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **MEDI MAX SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me Barna nga Lista Esenciale”** me nr. prokurimi 206-24-573-1-1-1, nxjerr:

**V E N D I M**

- I. **HEDHET POSHTË**, si e jashtëafatshme ankesa e OE ankues **MEDI MAX SH.P.K.**, e datës 08.03.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me Barna nga Lista Esenciale”** me nr. prokurimi 206-24-573-1-1-1, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues.
- II. Mbetet ne fuqi, Njoftimi për Kontratë i datës 31.01.2024 dhe sqarimet shtesë ne procedurë;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A R S Y E T I M**

Operatori Ekonomik **MEDI MAX SH.P.K** me datën 08.03.2024 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim e cila është e jashataftshme për tu trajtuar.

Afati i fundit për dorëzim te kërkesës për rishqyrtim ka qene deri me 07.03.2024 ora 16:00, ku brenda këtij afati është parashtruar një kërkesa për rishqyrtim nga OE Provit Pharmaceutical SH.P.K, e cila është shqyrtuar dhe është shtyre afati për ofertim deri me datën 15.03.2024 ora 14:00.

**Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim**

***Nenin 60.1(a) i Rregullave te prokurimit publik***

*Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për*

***dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.***

#### **Kronologjia**

Autoriteti Kontraktues, ka shpallur aktivitetin e prokurimit me date 31.01.2024.

Afati i fundit për dorëzim të tenderëve ishte 13.03.2024.

Me date 04.03.2024 është bere korrigjimi dhe shtyrja e afatit për ofertim për datën 15.03.2024.

Me date 27.02.2024 është parashtruar një kërkesë për rishqyrtim, e cilat është trajtuar me datën 04.03.2024 dhe është bere shtyrja e afatit për ofertim për datën 15.03.2024.

Ne perputhje me nenin 63.1.1 (b), i cili nen përcakton "Kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktues vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit duke vlerësuar dhe konsideruar arsyet e refuzimit dhe rrethanat në të cilat ndodhet aktiviteti i prokurimit" Ministria e Shëndetësisë me date 04.03.2024, ka publikuar Njoftimin mbi Korrigjimin e procedurës dhe ka shtyre afatin e dorëzimit deri me date 15.03.2024.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e juaj është dorëzuar me date 08.03.2024.

Ne perputhje me nenin 60.1. (a) , kërkesa e juaj për rishqyrtim është dorëzuar jashtë afatit kohor sepse afati prej se paku 5 ditëve ***nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.***

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

#### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit te këtij vendimi.

#### **Vendimi i dorëzohet:**

1. OE MEDI MAX SH.P.K.
3. Operatorëve ekonomik te interesuar.



**Berat Marmullaku**

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**